



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1120/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Tefik Ibrahimimi kandidat për anëtar të kuvendit komunal, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Gjilan paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë ndarjes së vendeve për asamblist për zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Tefik Ibrahimimi kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Gjilan, nga radhët e subjektit politik (AKR).

Arsyetim

PZAP-i , më datën 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Tefik Ibrahimimi kandidat për anëtar të kuvendit komunal, nga radhët e subjektit politik AKR, dega në Gjilan, në të cilën thekson se sipas rezultateve përfundimtare të QNR-së, rezultatet e kandidateve nëpër komuna , parashtuesi i ankesës thekson se ka 302 vota dhe se është me i votuar në AKR në Gjilan. KQZ-ja AKR-së i ka ndarë 2 vende për këshilltar komunal dhe atë Arben Maliqit bartësit të listës i cili ka 1909 vota dhe Mizaferë Ismajlit e cila ka 69 vota, ndërsa parashtuesi i ankesës thekson se ai përkundër që është më i votuari nuk figuron në tabelë të rezultateve të QNR-së, dhe se sipas tij KQZ-ja me këtë veprim ka bërë shkelje të rëndë duke përjashtuar kandidatin me 302 vota e duke i dhënë të drejtë kandidates me 69 vota.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë, ngase shpërndarjen e ulëseve nëpër kuvende komunale e bën KQZ-ja, në bazë të nenit 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale. Nga kjo nënkuptohet se është në kompetencë të KQZ-së, të bëjë shpërndarjen e ulëseve në kuvende komunale për secilin kandidat për anëtarë të kuvendeve komunale, duke respektuar kuotën gjinore siç kërkohet sipas dispozitës së lartcekur. Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e theksuara më lartë, si dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1120/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.